



KOLEGJI ESLG

Nr. 37 2019
Vendim
01 10/2019

Ne bazë të nenit 27, paragrafi 3 dhe 1, e Statutit të Kolegjit ESLG, Bordi Menaxhues miratoi këtë:

V E N D I M

Dr. Sc. Visar Hoxha emërohet Rektor i Kolegjit ESLG, me mandat tre vjeçar, duke filluar nga 01.10.2019 deri me 30.09.2022 me të drejtën e rizgjedhjes.

Rektori do të kompensohet në vlerë prej 558.83 euro bruto pagesë në muaj.

Rektori, sistemohet në punë dhe detyrat të punës, si më poshtë:

- a) Rektori është kreu akademik dhe shkencor i Kolegjit;
- b) Te përfaqësojë Kolegjin si institucion akademik;
- c) Te udhëheqë, mbikëqyrë dhe koordinojë studimet, hulumtimin dhe programet tjera akademike, projektet dhe njesite e Kolegjit;
- d) Te mbikëqyrë dhe koordinojë punën e njesive akademike të Kolegjit sic janë divizionet, departamentet, shkollat, fakultetet, libraritë dhe të tjera;
- e) Te ftojë dhe kryesojë seancat e senatit;
- f) Te bëjë propozime, nisma dhe opinione keshilldhënëse Bordit Menaxhues në çështjet akademike që nderlidhen me personelin akademik të Kolegjit;
- g) Përgatit programet e reja studimore bashkë me bartësit tjerë të programeve;
- h) Përgatit materialet e duhura për akreditim/riakreditim institucional dhe të programeve të studimit në bashkëpunim me organet e tjera të Kolegjit dhe bartësit e programeve.
- i) Përfaqëson Kolegjin në ngjarjet ndërkombëtare dhe vendore;
- j) Të bëjë propozime mbi politikën në fushën e procesit mësimor;
- k) Të merren masat e duhura në lidhje me rregullsinë dhe cilësinë e mësimdhënies;
- l) Të vendosë mbi aktivitetet në lidhje me përgatitjen për regjistrimin e studentëve në të tre ciklet e studimit, në nivel institucioni;
- m) Përgatit strategjitë e fakulteteve në nivel institucioni;
- n) Nënshkruan kontratat e stafit dhe studentëve;



KOLEGJI ESLG

- o) Propozon akte ligjore të përgjithshme dhe individuale në lidhje me mësimdhënies dhe çështjet e studentëve, si dhe zyret përkatëse në nivel institucioni.
- p) Kryen edhe pune të tjera të përcaktuara me Statut.

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqes ankesë, brenda afatit prej 15 ditësh Bordit Menaxhues të ESLG-së, pas këtij afati, vendimi merr formën e prerë.

Dorëzimi:

- 1. Bordit Menaxhues;
- 2. Rektorit;
- 3. Arkivës.



Kryetari i Bordit Menaxhues
Prof. Dr. Edmond Hajrizi